

Baza ligjore

Ligji nr 9001, date 14.04.2008 " Per tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare" , I ndryshuar
Ligji nr 139/2015 " Per Veteqeverisjen Vendore"

Neni 1
Data e Themelimit emri I shoqërisë

Sote me date 27/01/2020 , ne themeluesit , kemi kriuar nje shoqëri me pergjegjesi te kufizuar me emerin Sport Klub Bulqiza S.H.P.K

Neni 2
Themeluesit

Ortak I vetem themelues I kesaj shoqërie eshte **Bashkia Bulqize**, organ I pushtetit vendor me nr.Nipti K46915401W .**Bashkia Bulqize** do te jete ortak e vetme dhe do te zoteroje 100% te kuotave te kapitalit.

Neni 3
selia e shoqërisë

Selia e kesaj shoqërie do te jete "Lagjia Minatori Pedonale, Bashkia Bulqize" tek Bashkia Bulqize.

Kjo shoqëri mund te kete dhe seli te tjera te dyta, dege dhe filial, perfaqesi dhe agjensi operative ne te gjithe territorin e Republikës se Shqiperise dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

Shoqëri mund te ndryshoje seline, te hape zyra, perfaqesi, dege, filial si brenda dhe jashte Republikës se Shqiperise vetem me vendim te ortakut

Neni 4
Objekti

Objekt I veprimtarise te kesaj shoqërie dc te jete, Organizimi i aktiviteteve sportive ne fushen e futbollit. Krijimi i ekiyeve zinxhir per sportin e futbollit si dhe pjesemarrja ne garat sportive te organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Futja ne tregun e lojtare e per te blere lojtare sipas nevojave te ekipit. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interesa te shoqërisë. Aderimi dhe regjistrimi si klub ne Federaten Shqiptare te Futbollit dhe ne te gjitha llojet e aktiviteteve te futbollit koimbetare dhe nderkombetare. shoqëria Brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi do te kryje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj.

Neni 5
kohezgjatja

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te kesaj shoqërie do jete pa afat te percaktuar Shoqëria fiton personalitetin e saj juridik nga moment i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit

KREU II

Kreu II
Kapitali

Neni 6
Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Bashkia Bulqize : Zotues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 leke që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund eshte në para

Neni 7:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

d) dhurimit;

e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

Administratori

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

Andi Topi , me nr karte ID H71025156A I

Adresa Lagjia Minatori Bulqize

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptare ne Fuqi dhe vecanerisht Bazes ligjore te cituar ne kete akt themelimi.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

*** Sport Klub Bulqiza ***

Bashkia Bulqize

Kryetari

Lefter ALI

